



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.266/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër qendrës së vendvotimit numër 2101b, në Voinik-Skenderaj, për shkak të votimit pa ju marr gjurmët, pa përdorur llampë e as sprej gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.266/2017 e datës 12.06.2017, e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, lidhur me votimin e votuesve pa ju marr gjurmët, pa përdorur llampë e as sprej, në qendrën e votimit numër 2101b, në Voinik, Komuna e Skenderajt.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se gjatë ditës së zgjedhjeve, me datën 11.06.2017, komisionerët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në shkollën “Skender Skenderi” në qendrën e votimit 2101b, në Voinik-Skenderaj, ka konstatuar se kryesuesi i këtij vendvotimi, ka lejuar që votuesit të votojnë pa ju marr gjurmët, pa u kontrolluar me llampë e as prej dhe se komisionerët e tyre nuk kanë mundur ti ndalojnë këto veprime të jashtëligjshme, të njëjtit nuk janë lejuar që evidentojnë shkeljet në libër të votimit. Për këto arsye sipas dispozitave të rregullës zgjedhore kemi të bëjmë me shkelje të votimit të rregullt.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave-deklaratave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së,
gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, për të provuar pretendimet ankimore. Sepse nga prova e ofruara nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se është kryer shkelja e pretenduar në ankesë, kjo dëshmohet edhe nga deklarata e Kryesuesit i KVV-së, të qendrës së vendvotimit 2101b, Refki Ramaj, i cili në dëshminë e deponuar me datën 13.06.2017, për PZAP-it, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet si në ankesë për faktin se komisionerët e subjektit Lëvizja Vetëvendosje, kanë qenë të vendosur në pikat kyqe në vendvotim, njëri tek dera me llampë e tjetri tek libri i votimit dhe se ka pasur vetëm tendenca të votuesve për të hyr në vendvotim por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Po ashtu kryesuesi i vendvotimit deklaroi se çdo gjë është e shënuar në libër të votimit si dhe deklaratat e komisioneve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje të cilët janë larguar nga vendvotimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.266 /2017 më datën 14.06.2017



**Kryesues i Panelit
Hasan Shala**

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*